

DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



KRYETARI I ODËS EKONOMIKE TË KOSOVËS/PARALAJMËRUAM PËR MBYLLJEN E PJESSHME NDËRSA RAJONI ME MASA MË TË LEHTA

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi ka thënë se në takim me zyrtaret nga Qeveria, i kanë paralajmëruar për atë se çka mund të ndodh nëse në Kosovë ka mbyllje të pjesshme, ndërsa në rajon, sidomos në Shqipëri ka masa më të lehta. “Shkupi është larg vetëm 1 orë nga Prishtina. Çdo vendim që merret për çfarëdo çështje, jo vetëm për COVID, duhet ta ketë parasysh këtë ndërlikohje. Kemi mësuar shume për 1 vit duke u ballafaquar me pandeminë, prandaj na duhen vendime racionale të cilat prodhojnë efekt në menaxhimin e pandemisë dhe nuk e dëmtojnë ekonominë”.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



INDUSTRIA E PRODHIMIT KA HYRË NË NJË CIKËL TË QËNDRUESHËM RËNIE, QË KA NISUR PARA PANDEMISË, NË VITIN 2019.

Aplikimi i masave kufizuese në vendet e BE-së ka ulur porosinë për fabrikat e këpucëve në 65-75% në shkurt-mars 2021 dhe për veshjet në 30-40%. Fabrikat po përballen me falimentet dhe lajmërojnë 20 mijë largime nga puna në 6-mujorin e parë 2021. Në mungesë të mbështetjes me likuiditet, prodhuesit shqiptarë nuk përfituan nga kërkesa e re që nxiti pandemia dhe nga ndryshimi i zinxhirëve të furnizimit. Pritshmëritë për rikthim në normalitet janë shtyrë në fund të vitit 2023. Bizneset e sektorit presin të nisin rimëkëmbjen në muajin tetor, nëse vaksinohet 60% e popullsisë së Europës, ndërsa niveli i vitit 2019 do të arrihet në vitin 2023.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



FMN DHE BB KËRKOJNË TË BËHET KUJDES NË PERIUDHËN POST-COVID, SYTË NGA VAKSINIMI PËR KTHIMIN E STABILITETIT EKONOMIK

Banka e Shqipërisë ka qenë pjesë e një takimi me BB dhe FMN, ku u diskutua ecuria e ekonomisë shqiptare gjatë pandemisë dhe masat për të nisur rikuperimin ekonomik. BB dhe FMN shprehen se aktorët kryesorë në vend duhet të krijojnë politika të cilat mbajnë të qëndrueshme stabilitetin ekonomik në vend dhe nxisin rritjen ekonomike. BB dhe FMN kërkojnë që qeveria shqiptare të përmirësojë në vijim ndërthurjen mes politikave fiskale dhe monetare, pasi të dyja janë të rëndësishme për të mos rritur borxhin publik dhe mbajnë të qëndrueshme gjendjen financiare të ekonomisë.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



JAVA NË LAJME

SUEDI/ NJË PROJEKTLIGJ PËR EMIGRACIONIN, JA ÇFARË KËRKOHEM



SIPËRMARRËSI TROKA DHURON 2000 MASKA FFP2 NË HORËN E ARBËRESHËVE



HISTORIA/ KAMPIONI SHQIPTAR NË GREQI, RIKTHEHET DHE INVESTON NË VENDLINDJE



KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	104.6	105.2
EUR	122.9	123.5
CHF	110.8	111.6
GBP	143.4	144.4
DKK	16 ^{.22}	16.62